



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË

Bordi

VENDIM

Nr. 90, Datë 20.04.2018

MBI

FILLIMIN E PROCEDURËS PËR SHQYRTIMIN E KËRKESËS SË SHOQËRISË “MP-HEC” SH.P.K, PËR LICENCIM NË AKTIVITETIN E PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA HEC “NIÇE” ME FUQI TË INSTALUAR 1.668 MW

Në mbështetje të neneve 16; 37, pika 2 gërma “a”; të Ligjit nr. 43/2015, “Për Sektorin e Energjisë Elektrike” ndryshuar; neneve 4, pika 1, gërma “a”; 5, pika 1 gërma “a” dhe nenit 10, pika 3 të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e bordit të ERE, nr. 109, datë 29.06.2016, si dhe neneve 15 dhe 19, pika 1, gërma “a”, të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE”, miratuar me vendimin e bordit të ERE nr. 96, datë 17.06.2016; bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 20.04.2018, mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut, në lidhje me licencimin në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike të shoqërisë “MP - HEC” sh.p.k nga HEC “NIÇE”, me fuqi të instaluar 1.668MW,,

Konstatoi se :

- Shoqëria “MP-HEC” me shkresën nr.7 Prot, datë 26.03.2018, protokolluar në ERE me Nr. 286 Prot., datë 28.03.2018, ka paraqitur kërkesën për tu pajisur me licencë në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike nga Hec “Niçë”.
- Në oponencën teknike të kryer nga AKBN, mbi Projektin e Zbatimit të përmirësuar të Hec “Niçë”, dërguar MEI-t, me shkresën nr. 5032/1 Prot, datë 10.06.2015, nga subjekti “MP - HEC” sh.p.k, përcaktohet se fuqia e instaluar e Hec “Niçë”, do të jetë 2270 KW. Lidhur me këtë oponencë, nga subjekti nuk është paraqitur ndonjë shkresë miratimi nga ana e MEI-t, për projektin e zbatimit të përmirësuar të Hec “Niçë”. Nga ana tjetër në kërkesën e tij për licencim, subjekti sipas formatit të aplikimit kërkon të licencohet për një fuqi të instaluar të Hec “Niçë”, prej 1668 KW.
- Aplikimi i shoqërisë “MP – HEC sh.p.k., plotëson pjesërisht kërkesat e parashikuara nga ERE në “Rregulloren për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike” si më poshtë:

- Formati i aplikimit (neni 9, pika 1, gërmat, “a”, “b”, “c”) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacionin juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2, gërmat, “a”, “b”, “c”, “d”, “e”, “f”, “g”) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni financiar dhe fiskal (neni 9, pika 3, gërmat, “a”, “b”, “d”), është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni teknik për HEC (neni 9, pikat 4.1.1, 4.1.2, 4.1.3, 4.1.4 dhe 4.1.5), është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.

Për mungesën e dokumentacionit që ka të bëjë me nenin 9, pika 3, gërma, “c”, (dokumenta që vërtetojnë aftësinë ose mbështetjen financiare të aplikuesit), do të njoftohet subjekti që t’i paraqesë ato brenda afateve që përcakton “*Rregullorja për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licensave në sektorin e energjisë elektrike*”.

Për gjithë sa më sipër cituar, bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. Të fillojë procedurën për shqyrtimin e kërkesës së shoqërisë “MP - HEC” sh.p.k., për licencim në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC “Niçe”.
2. Drejtoria e Licensimit dhe Monitorimit të Tregut, të njoftojë aplikuesin për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga botimi në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit AHMETI